



Ne baze te nenit 12, paragrafi 2, shkronja (c), të Ligjit Nr-03/L-040, për Vetëqeverisjen Lokale, "Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr-28/2008", neneve 15, 29, pika 2 te Statutit te Komunës se Suharekës, 01-Nr-8336, i datës 04.11.2008, nenit 5 lidhur me nenin 7, pika 3, te Ligjit Nr-04/L-144, për dhënien ne shfrytëzim dhe këmbimin e pronës se paluajtshme te Komunës, "Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr-35/2012", nenit 4, lidhur me nenin 5, të Rregullores QRK, Nr-23/2013, për përcaktimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim dhe këmbimit të pronës së paluajtshme të Komunës, Kuvendi i Komunës në Suharekë në mbledhjen e mbajtur me datë, 19.07.2018, miraton këtë:

V E N D I M

Neni 1

1.1 JEPET PËLQIMI- për të zhvilluar procedurat e ankandit publik për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër prej 1, (një) deri në 15, (pesëmbëdhjetë), vite të pronës së paluajtshme të komunës:

1.2 Sipërfaqja prej **100m²** nga sipërfaqja e përgjithshme prej **225160m²**, në parcelën kadastrale **P-72116029-00197-0**, sipas certifikatës së pronës **nr. 952-2/2018-2784**, datës 05.07.2018, zona kadastrale **Mushtisht**, vendi i quajtura **"Nerezine"**, e evidentuar pasuri shoqërore në emër të Kuvendit Komunal-Suharekë, për vendosjen e antenës telefonike.

Neni 2

OBLIGOHET-Drejtoria për shërbime pronësore juridike dhe kadastrë dhe zyra e prokurimit që në bashkëpunim me komisioni për zbatimin procedurave të dhënies në shfrytëzim të pronës se paluajtshme të Komunës, afatshkurtër dhe afatgjatë, që të zhvilloj procedurat e ankandit publik, konform dispozitave të Ligjit Nr-04/L-144, për dhënien ne shfrytëzim dhe këmbimin e pronës se paluajtshme te Komunës, "Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr-35/2012" dhe të Rregullores (QRK) Nr-23/2013, për përcaktimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim dhe këmbimit të pronës së paluajtshme të Komunës.

Neni 3

Pas miratimit nga ana e Kuvendit të Komunës në Suharekë, ky vendim hyn në fuqi 15, ditë pas dërgimit në autoritetin mbikëqyrës, në kuptim të nenit 81, të Ligjit Nr-03/L-040, për vetëqeverisjen lokale, "Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr- 28/2008", nenit 8, të Rregullores, Nr-01/2016, për shqyrtimin administrativ te akteve të Komunave dhe pas shpalljes publike në tabelën e shpalljeve ose web-faqen zyrtare të Komunës.

KUVENDI I KOMUNËS-SUHAREKË

01-Nr-016-41959
Më datë 19.07.2018



Kryesuesi i Kuvendit

Bexhet KUÇI